

Ttitulli	Vlerësimi i parametrave për ujë të pijshëm të sigurtë, ujrat sipërfaqësorë, shkarkime urbane dhe industriale, tokat
Institucioni	Instituti i Shëndetit Publik, Departamenti Shëndeti dhe Mjedisi
Përshkrimi	<p>Çdo institucion shtetëror, privat, biznes apo palë e interesuar që ka interes në fushën e sigurisë së cilësisë së ujrave apo ndeshet me problematika që lidhen me sigurinë e cilësisë së ujrave, tokave etj. mund të paraqitet në ISHP, për vlerësimin e cilësisë së tyre . Parametrat e vlerësimit janë mikrobiologjike (Mikroflora e përgjithëshme në 37 gradë celcius, E. Coli, Coliformë Total, Streptokoku fekal, Clostridium perfringens, Pseudomonas aeruginosa, Stafilokoku aureus dhe në raste të indikuara nga specialistët Salmonela , Shigela dhe Vibrioni i Kolerës.</p> <p>Parametra të tjerë janë ata të vlerësimit kimik (parametrat organoleptik, përmbajtja e kripërave në ujra, fortësia e përgjithëshme, amonjaku, nitritet, nitratet , kloruret, sulfatet, fosfatet, azoti total, lënda organike etj. Për ujrat sipërfaqësore përveç elementëve të mësipërm kimike përcaktohen edhe BOD-5 dhe COD.</p> <p>Për vlerësimin kimik për treguesit toksikologjike në ujra dhe toka përcaktohen: 1. Metale të Rënda (Cu, Hg, Cr, Ni, Zn, Mn, As, Cd, Pb, Fe); Pesticidet klororganike ; Hidrokarburet Policiklike Aromatike (PAH), Vajrat dhe Grasot në ujra dhe toka;</p> <p>Uji i pijshëm i analizuar për parametrat e mësipërm që të përdoret për konsum njerëzor, duhet të plotësojë kriteret e cilësisë së tij të paraqitura në Standartin aktual shqiptar STASH 3904 – 1997. Ujrat e analizuar në laboratorë që nuk plotësojnë kriteret e cilësisë së ujit të pijshëm, të paraqitura në standartin aktual nuk mund të përdoret për furnizimin publik. Ujrat e analizuar në laboratorë, përfaqësojnë burimin e ujit, veprën e marrjes së ujit, depon apo rrjetin ujësjellës në të cilin është marrë mostra e ujit.</p> <p>Për vlerësimin analitik të ujrave, shkarkimeve apo tokave, hartohet Raporti i Analizave, me rezultatet e përfuara në laboratorë , të cilat mund të jenë parametra detyrues (lidhur me sigurinë e cilësisë së ujit) si dhe parametra të tjerë cilësorë të ujit. Ky raport është i vlefshëm për palën e intresuar lidhur me qëllimin për të cilin ai ka interes.</p> <p>Pas kryerjes se analizave, një kopje e Raport-Analizëz dërgohet në zyrat e financës së Institucionit, për përgatitjen e faturës së pagesës , në bazë të shërbimit të kryer.</p> <p>Subjekti, tërheq nga Financa, faturën e pagesës dhe drejtohet në bankë, për të kryer pagesën e shërbimit të kryer, për llogari të Institucionit.</p> <p>Pas kryerjes së kësaj pagese nga ana e subjektit, në Institucion dërgohet nga ana e subjektit një kopje e dokumentit ku vërtetohet nga ana e jonë që pagesa është kryer.</p> <p>Pas kryerjes së kësaj procedure, Raport-Analiza firmoset nga personat përgjegjës, titullari i Departamentit dhe Institucionit, protokollohet në sekretarinë e ISHP-së, dhe subjekti/personi i interesuar merr një kopje zyrtare të Raportit të hartuar.</p>
Dokumentacioni i nevojshëm	Institucioni apo pala e intresuar për analiza të ujrave paraqitet në sekretarinë e Institucionit ku dorëzon një kërkesë në të cilën duhet të jetë

	<p>e përcaktuar qartë arsyeja e bërjes së analizës si dhe adresa e saktë e vendit ku do të merret uji për analizë.</p> <p>Institucioni apo pala e intresuar për analiza dhe sjell kërkesën duhet të ketë me vete një mjet identifikimi dhe në raste të bizneseve edhe nr. e licensës së biznesit (Niptin).</p> <p>Institucioni apo pala e intresuar për analiza pas mbarimit të procedurave të nevojshme si analiza , hartimi i raportit dhe bërja e pagesës financiare nga ana e të interesuarit, pajiset nga Institucioni me raportin përfundimtar i cili mund të merret vetë nga i interesuari ose mund ti dërgohet atij me postë.</p>	
Hapat e procedurës	<p>Për kryerjen e shërbimit për analiza të ujërave, Institucioni apo pala e interesuar paraqitet pranë sekretarisë së ISHP-së i cili dorëzon një kërkesë. Në kërkesën e bërë duhet të jetë e shkruar qartë emri apo subjekti që bën kërkesën me adresë të saktë, qëllimin për të cilin kërkon të bëhet analiza, adresa e saktë e vendit ku do të merret uji për analizë dhe një numër telefoni kontakti apo adresë e-mail. Kjo kërkesë dorëzohet pranë sekretarisë së Institutit të Shëndetit Publik e cila më pas i kalon titullarit të Institucionit për vlerësim (miratim), e më pas protokollohet.</p> <p>Kërkesa, pasi firmoset nga titullari i Institucionit, i adresohet për zbatim titullarit të Departamentit të Shëndeti dhe Mjedisi. Kërkesa apo shkresa vlerësohet nga shefi i Departamentit , i cili më pas e dërgon në Sektorin e Ujit dhe Sanitetit për fillimin e procedurave të analizave në laborator.</p> <p>Mostra e sjelle nga pala e interesuar duhet të merret nga personeli i Drejtorive të inspektoriatit sanitar shtetëror të rrethit përkatës nga vjen subjekti, i cili e shoqëron mostrën e ujit me një dokument (proces-verbal marrje mostre) i cili duhet të jetë i firmosur nga Inspektoriatit dhe i vulosur nga Institucioni i Inspektoriatit Sanitar , si dhe duhet të firmoset edhe nga pala e interesuar. Mostrat shoqërohen në laborator në kushtet e temperaturës jo më shumë se 4 0 C, në termobokse.</p> <p>Mostra (at) e sjelle (a) për analizë regjistrohen në regjistrat e pranimit të mostrave të ujërave pranë seksionit, plotësohet formulari i dërgimit të mostrës për analizë, firmoset nga përgjegjësi i seksionit dhe dërgohet në laboratorët përkatës sipas specifikes së analizës.</p> <p>Kjo procedurë zgjat 7 deri në 21 ditë në varësi të tipit të analizës që do të kryhet dhe ngarkësës në laboratorë.</p>	
Kushti i vendimit	Ky lloj shërbimi ofrohet cdo ditë të javës nga e hëna – të enjte nga ora 9:00 – 15:00 dhe të premte nga ora 9:00 –13:00	
Periudha e vlefshmërisë	Raporti i vlerësimit në përfundim të procedurës është i vlefshëm vetëm për mostrat e analizuar në laborator dhe për sit	
Shpenzimet	Ky raport ka një kosto të përcaktuar në varësi të parametrave të analizuar (shih tek adresa URL e ISHP-së), çmimet e analizave të ujërave;	
Adresa URL	www.ishp.gov.al	
Subjekti	Mjedisi, Shëndeti dhe mirëqënia, Biznesi	
Profili	Biznes	
Zyrë	Departamenti “Shëndeti dhe Mjedisi”	
Sheshi/ Rruga	Rruga Aleksandër Moisiu	Numri i rrugës 80
		Kodi postar

Qyteti	Tiranë
Orari i hapjes	Të Hënë - Enjtë, nga ora 8:00 - 16:30 dhe të Premte nga ora 8:00 - 14:00, (Për analizat mikrobiologjike orari i pranimi të mostrave të ujërave është ditën e Hënë; të Martë dhe të Mërkurë , për shkak të veçorisë analitike të tyre)
Numri i telefonit	355 42374756
Adresa e email-it	Arben.Luzati@ishp.gov.al